

**SHOQERIA “KUKES INERTE” SH.P.K**

**PERMBEDHJE JO TEKNIKE E AKTIVITETIT  
“ IMPIANT FRAKSIONIMI TE INERTEVE DHE PRODHIMI TE  
BETONIT ”**

**SUBJEKTI: “KUKES INERTE” SH.P.K**

**KANTIERI: KUKES**

**AKTIVITETI: IMPIANT FRAKSIONIMI TE INERTEVE MALORE DHE  
PRODHIM BETONI**

**VENDODHJA: KOMUNA KOLSH, RRETHI KUKES, QARKU KUKES**

Permbledhje jo teknike per aktivitetin e nyjes se betonit dhe te inerteve te shoqerise "KUKES INERTE" Sh.p.k



## **PERMBAJTJA**

### **1. Pershkrimi**

- Vendndodhja e projektit
- Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit
- Kerkesat e perdorimit te tokes

### **2. Pershkrim te shkarkimeve ne toke, uje dhe ajer.**

### **3. Mjedisi ne zone dhe ndikimet nga veprimtaria.**

### **4. Masat parandaluese per te zbutur ndikimet ne mjedis.**

### **5. Procedura e ndjekur nga subjekti e strukturat pergjegjese per vendimmarrje.**

## PERSHKRIMI

### Vendodhja e objektit. Aktiviteti

Vendi i kerkuar per instalimin e impiantit te fraksionimit te inerteve dhe te prodhimit te betonit ndodhet ne komunen Kolsh, rrethi Kukes, ne anen e majte te autostardes Rreshen-Kukes, rreth 150-200 m larg bregut jugor te liqenit te Fierzes, si dhe rreth 1.5 km poshte ures ne hyrje te qytetit te Kukesit.

Sheshi ndodhet ne toke inproduktive.

Ne hapjen dhe shfrytezimin e impiantit te fraksionimit shoqeria ka marre te gjitha masat per zbatimin me perpikemeri te projektit te hartuar per te siguruar nje zhvillim normal te procesit te fraksionimit dhe prodhimit te betonit pa demtuar mjedisin.



Kufizimet e sheshit te impianteve:

- Veri – eshte kufizuar me token inproduktive ne breg te liqenit te Fierzes
- Lindje – me token inproduktive ne breg te liqenit te Fierzes
- Jug – me rrugen e Kombit, aksi Rreshen-Kukes
- Perendim – me token ne pronesi te Xhemal Koldashi

### Qellimi i objektit

Projekti i paraqitur nga Shoqeria “KUKES INERTE” Sh.p.k, per tu ripajisur me Leje Mjedisi Tipi B, ka per qellim fraksionimin e inerteve malore dhe prodhimin e markave te ndyshme te betonit.

Zona ku do zhvillohet aktiviteti ndodhet ne komunen Kolsh, rrethi Kukes. Per te realizuar respektimin e mjedisit dhe per te ulur ndikimin e impaktit ne mjedis, shoqeria “KUKES INERTE” Sh.p.k, ka planifikuar te instaloje makineri dhe pajisje bashkekohore.

### **Kerkesat e perdorimit te tokes**

Perdorimi i tokes per zbatimin e ketij projekti do te behet vetem ne siperfaqen e kerkuar dhe duke mos perdorur toke tjeter.

Prandaj nuk lind nevoja e perdorimit dhe rehabilitimit te tokave jashte projektit, sepse aktiviteti do te zhvillohet brenda siperfaqes 8738 m<sup>2</sup>

### **Vendet dhe proceset alternative te marra ne konsiderate**

Nisur edhe nga qellimi i kesaj veprimtarie, shqyrtimi i alternativave eshte i thjeshte, sepse lidhet me prodhimin, marrjen dhe transportin e lendes se pare, e cila prodhohet nga shoqeria KUKES INERTE Sh.p.k.

Kapaciteti i inerteve te gurit eshte mesatarisht rreth 60.000 m<sup>3</sup>/vit.

- Prodhimi, marrja dhe transporti i lendes se pare behet nga shoqeria KUKES INERTE Sh.p.k.
- Paraqet mundesi aksesit rrugore ne objekt dhe faktoret klimatike te zones favorizojne veprimtarine.
- Ne zone ekziston krahu i punes.
- Nuk cenon vlere cilesore apo te vecanta mjedisore dhe sociale.
- Eshte miratuar nga institucionet lokale te shtetit dhe komuniteti i zones.

### **Lenda e pare per linjen e fraksionimit te inerteve**

Lenda e pare per linjen e fraksionimit te inerteve sigurohet nga shfrytezimi i gurores ne zonen minerare 387/1, objekti “Kolsh”, Qarku Kukes.

Kjo lende e pare eshte me perberje granulometrike te ndryshme. Zakonisht ka kete perberje :

→ Gur masiv

→ fraksioni 80-100 mm

→ fraksioni 40-60 mm

→ fraksioni 0-25 mm

→ lageshtia 10 %

#### **- Produkt i gatshem**

→ rere e thyer ne masen 15 %

→ rere e dale nga bluarja 15 %

→ granil 5-10 mm 25%

→ granil 10-20 mm 20%

Cakull, saibes, tampon e stabilizant 25%

Keto produkte perdoren si lende e pare per linjen e betonit.

### *Sheshi per depozitim te lendes se pare*

Sheshi i ndertimit te perdorur per kete objekt, perfaqeson nje siperfaqje toke te sheshte me nje disnivel te pershtatshem, per instalim linje te tille te fraksionimit.

Siperfaqja e zene per kete objekt, nuk eshte toke produktive per bujqesi, e deri tani nuk ka patur interes nga strukturat ligjore per perdorim tjeter.

Sheshi ku zhvillon aktivitetin subjekti “KUKES INERTE” Sh.p.k me administrator z. Zelfi Oruci, sipas te dhenave te subjektit eshte pa konflikt pronesie.

Ne kete shesh behet depozitimi i materialeve inerte te siguruara nga shfrytezimi i gurrores ne zonen minerare 387/1, objekti “Kolsh”, Qarku Kukes.

Kjo veprimtari kryhet me mjetet perkatese te ngarkim- shkarkimit.

Siperfaqja ku zhvilloht aktiviteti eshte **S.totale** = 8738 m<sup>2</sup>

Nga ku:

S1= 5 500 m<sup>2</sup> e zene makinerite e impianteve,

S2= 3 238 m<sup>2</sup> e ze stoku i materialit dhe hapesirat e tjera.



### *Linja e fraksionimit te inerteve dhe impianti i prodhimit te betonit*

**Linja e fraksionimit** ka per qellim larjen dhe fraksionimin e materialeve inerte malore dhe realizim te produktit final rere e thyer, granil, cakell si materiale per prodhim betoni, si dhe per industrine e ndertimit.


Shoqeria “KUKES INERTE” sh.p.k ka investuar nje teknologji bashkekohore te standarteve europiane nje impiant fraksionimi me kapacitet 60 m<sup>3</sup>/ore te tipit Kue-Ken KK120 / Brown Lennox Jaw Crushers.

Ky impiant eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise, ku pjese teknologjike te ndryshme te ketij impianti nderrohen ose modifikohen me te reja dhe shpikje inxhinierike, te cilat permiresojne eficencen dhe optimizojne perdorimin e energjise dhe ndikimin ne mjedis.

Linja e prodhimit te materialeve te inerte per ndertim perbehet nga keto elemente:

1. Bunkeri prites i lendes se pare
2. Transportier i pjerret qe sherben per furnizim te linjes, me pajisjet ndihmese
3. Site vibruese me 3 kate dhe kapacitet perpunues 60 m<sup>3</sup>/ore
4. Pajisje tip shnek per transportin e materialit te imet (rere)
5. Bunker i depozimit te produktit te gatshem me vellim 25 m<sup>3</sup>
6. Ulluk per shkarkimin e mbeturines
7. Linja e furnizimit me energji elektrike dhe ajo e furnizimit me uje
8. Mulli me çekiç, per bluarjen e fraksionit te madh te dale pas larjes se fraksionimit 0- />20 mm.

Nga sistemi sitave vecohen agregatet me madhesine e kerkuar, konkretisht: granil-2, granil- 1, dhe rere e thyer/perpunuar te cilat i nenshtrohen procesit te larjes dhe transportohen per ne sheshet e tyre nepermjet transportiereve perkates.



**Impianti i prodhimit te betonit** eshte vendosur ne kete shesh, krahas te impiantit te fraksionimit.

Kapaciteti qe do te te kete impianti eshte llogaritur rreth 60 m<sup>3</sup>/ore. Konsumi per uje do te zgjidhet me ane te 3 depozitave qe do te vendoset ne kete prone per nevojat e kesaj linje te prodhimit te betonit. Uji do te sigurohet permes nje pusi, per te cilen subjekti “Kukes Inerte”, do aplikojte per leje shfrytezimi prane Agjensise se Menaxhimit te Burimeve Ujore. Impianti nyje betoni do te montohet te sheshi i planifikuar ku do prodhohet beton i gatshem.

- *Teknologjia*

Impianti i prodhimit te betonit perbehet nga keto makineri dhe pajisje


1. Dy bunkerat sillosat me kapacitet 60 ton/njesi
2. Transportiere,
3. Paisjet e dozimit,
4. Paisjet e komandimit automatik.

- *Proceset*

Betoni merret nga perzierja e cimentos me agregat fin (rere) me agregat te ashper (cakall apo gur te thyer) dhe uje. Sasi te vogla kimikatesh te quajtuara perzierje shpesh here i hidhen mases se betonit qe ta kontrollojne kohen e perforcimit dhe plasticitetin apo disa karakteristika te tjera. Menyra tipike perzierjes se betonit sipas mases eshte 10% deri ne 15% cemento, 65-75% agregate dhe 15-20% uje.

Cimentoja agregate dhe uji hidhen ne makinerine per perzierje sipas recetes se testuar dhe te miratuara paraprakisht. Agregatet dozohen nepermjet mbushesit dhe transportohen me lehte ne makinerine per perzierje ku i hidhet uje, perzierje kimikate dhe cemento. Koha e perzierjes eshte rreth 30 minuta. Betoni i gatshem hidhet direkt ne kamionin perzieres nepermjet rreshqitesit ne forme konike.

Prodhimi i betonit behet sipas skemes se me poshtme:



Mendohet qe te punohet rreth 250 dite ne vit, me nje prodhimtari rreth 25 mije m<sup>3</sup> beton dhe me nje prodhimtari mesatare 60 mije m<sup>3</sup> inerte.



## **Energjia dhe Lenda djegese**

Te dy impiantet punojne me energji elektrike me nje konsum mesatar vjetor rreth 100 mije kwh. Energjia elektrike eshte nga linja e afert e zones, me nje kabine shtyllore me transformator me fuqi 400 kWh.

Ne mungese te energjise funksionon edhe gjeneratori, i cili furnizohet me nafte dhe ka nje kapacitet 75 kw/H. Procesi i fraksionimit dhe ai i betonit nuk perdorin lende djegese. Mjetet e transportit e ato te ngarkim shkarkimit dhe betonieret perdorin lende djegese te lenget gasoil, me nje konsum mesatar te tij rreth **30 ton**.

Theksojme se perdorimi i ketyre burimeve nuk ka ndikim ne zone, sepse sigurohen sipas procedurave dhe nga subjekte te licensuara.

## **2. Pershkrim te shkarkimeve ne toke, uje dhe ajer.**

### **Uje industrial**

Uji qe perdoret per larje te reres dhe per prodhim betoni, sigurohet me pus shpimi, ne sheshin brenda territorit te linjes, me thellesi 60 m dhe me nje prurje  $Q= 5$  litra/sek. Uji qe konsumohet per nje vit eshte rreth  $40\ 000\ m^3$ .

### **Mbetje nga procesi teknologjik**

Mbetje teknologjike fraksion i imet nga linja e inerteve, qe varion 1- 5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar, mase e cila kalon me ujerat. Kjo mase pas dekantimit sistemohet dhe riperdoret nga zona. Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linjes se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime, si dhe ne linjen e bluarjes. Kjo sasi mbetje eshte 5-10 % te sasise se lendes se pare te perdorur. Sterilet apo mbetje te tjera perdoren per nevoja teknologjike ose vendosen per rehabilitimin e zones perreth.

Ne rast rrjedhjesh aksidentale te vajrave apo hidrokarbureve ne sheshin e punes subjekti do te realizoje pastrim te mases se ndotur permes tallazhit apo reres dhe keto papasterti do depozitohen ne fuci metalike. Gjithashtu, subjekti do te lidhi kontrate me subjekte te licensuara per trajtimin dhe transferimin e ketyre mbetjeve.

Produkti i gatshem rere e granil, cakell, stabilizant, saibase per ndertim, depozitohet ne sheshin e objektit ne varesi te tregut te shitjes.

Sasia e llumrave qe mund te dalin nga paradekantimi i ujerave te larjes do te perdoret per sistemimin e shesheve te punes, si dhe rifutet ne procesin teknologjik, duke qene se ka te njejten natyre me lenden e pare.

### **Shkarkimet e lengeta**

Kompania ka marre masa qe ujerat industrial, qe gjenerohen gjate procesit teknologjik ne linjen e fraksionimit, ujerat e shesheve te punes dhe te reshjeve, te orientohen ne grope dekantuese, per te evituar derdhjet e llumrave dhe mbetjeve te ngurta.

Sasia e ujerave industriale te linjes se bashku me ujerat siperfaqesore te krijuara nga reshjet etj., duhet te plotesojne perpara shkarkimit ne mjedisin uhor prites, parametrat brenda normave ligjore, duke iu nenshtruar monitorimit periodik sipas ligjit.

### **Shkarkime ne toke**

Vendi ku depozitohet lenda e pare eshte i shtruar me beton dhe qe ne fazen e ndertimit eshte e veshur me nje shtrese gjeotekstile e cila nuk lejon depertimet ne toke.

### **Shkarkime ne ajer**

Referuar natyres se procesit ne atmosfere kemi shkarkime si grimca te ngurta dhe gaze (SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, CO<sub>x</sub>), shkaktuar respektivisht nga pluhuri gjate procesit te punes dhe levizjes se mjeteve te transportit ne kantier. Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se bluar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Ne raste te tilla subjekti perdor sperkatjen me uje here pas here, ndersa makinat transportuese jane te mbuluara. Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtera, brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth.

### **Zhurmat dhe vibracionet**

Bazuar ne tipin e makineri-paisjeve te linjes dhe mjeteve te transportit, ne objekt jane te pranishme zhurmat dhe vibracionet.

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim - shkarkimit, sitat vibruese, mulliri, perzieresi, etj. Theksojme se norma e lejuar per zona industriale ne periferi te tyre nuk duhet te kaloje ne nivelin **70 dB**. Per te minimizuar deri ne normat shendetesore ligjore sipas instruksioneve te sigurise ne pune dhe shendetin, per operacione pune te tilla, subjekti duhet te marre masa parandaluese te zhurmave e vibracioneve, si me sinkronizim e alterim te kohes se punes e radhes se veprimeve, perdorim i mjeteve mbrojtese (kufie per zhurmat e kepuce me take te larte gome per vibracionet) e kontroll periodik shendetsor te punonjesve sipas kerkesave perkatese ligjore.

Perdorimi i ketyre kufjeve ul intesitetin e zhurmes rreth 30 dB referuar atij qe eshte ne mjedis.

Norma e lejuar ne zonat rezidenciale nga **ora 07:00 deri 22:00 , nuk duhet mbi 60 dB, kurse per naten ora 22:00 deri ne 07:00 te mengjesit , nuk kalon mbi 35-45 dB.**

Meqense objekti punon vetem ne turnin e pare zakonisht ora 07:30 -16:30, si dhe faktit se eshte larg zones se banuar ( shtepia me e afert eshte rreth 1km, ndersa qyteti Kukes rreth 2 km), mendojme se ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth.

### **3. Mjedi si ne zone dhe ndikimet nga veprimtaria.**

**Komuna Kolsh** eshte nje njesi e pushtetit lokal te rrethit te Kukesit, ku perfshihet ne Qarkun e Kukesit, dhe shtrihet ne pjesen perendimore te Bashkise Kukes, ku kufizohet pergjate shtrirjes se Liqenit te Fierzes. Ne pjesen jugore kufizohet me komunen Surroj dhe ne lindje me ate te Malziut. **Rrethi i Kukesit** me nje siperfaqe prej 956 km<sup>2</sup>, perfshin nen administrimin e tij 1 bashki dhe 14 komuna me kryeqender Kukesin.

#### **Popullsia**

Komuna Kolsh perbehet nga 3 fshatra: Kolsh, Myç-Mamez dhe Mamez me nje popullsi gjithsej prej 2340 banoresh, ndersa rrethi i Kukesit ka rreth 65.000 banore.

Qe nga viti 1990, popullata perjetoi nje renie dramatike (rreth 30%), edhe pse kjo prirje negative eshte zvogeluar ne periudhen 2006-2010. Dy tendencat te rendesishme kane qene te

pranishme ne kete qark: shpopullimi i pergjithshem i ndjekur nga migrimet nder-rajonale nga zonat rurale ne qendrat urbane. Ndermjet 2006 dhe 2010, popullsia e bashkise u rrit me 3.8 %, ndersa ne komuna ajo ka rene me 2.5 %. Dendesia mesatare rajonale e popullsise eshte 53 banore/km<sup>2</sup>, e qendrueshme qe nga viti 2006.

Kukesi ka nje popullsi relativisht te re. Grupi i moshes 0-14 perfaqeson 38.5% te popullsise, grupmosha 15-64 vjeç perben 45.9% te totalit, ndersa 15.6% eshte mbi 64 vjeç. Tendencat e tre grupmoshave te permendura me siper kane qene pak a shume te qendrueshme qe nga viti 2006.

Faktoret kryesore qe kontribuojne ne keto zhvillime demografike jane te lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shume ndermarrjeve ne pronesi shtetore dhe papunesise qe e shoqeroi, terrenit ne pergjithesi te veshtire, kushteve te pafavorshme klimatike dhe bujqesore.

Ky projekt nuk ndikon ne popullsi dhe per pasoje nuk ka ndikime pasuese mjedisore. Meqenese eshte nje zone me papunesi te larte , qe arrin 30-35 % te popullsise se afte per pune ne keto kushte zbatimi i ketij projekti ndikon pozitivisht ne zbutjen e problemit social, duke punesuar rreth 12 persona.

Gjithashtu ky aktivitet ndikon shume ne industrine e ndertimit te zones, duke pare dhe tendencat ne rritje, si shkak i pozicionit gjeografik te zones, sidomos pas ndertimit te rruges se Kombit.

### **Trashegimia kulturore**

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures . Ne zonen e impiantit nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike. Ato ndodhen ne largesi te mjaftueshme me zonen ne studim ku as ne menyre direkte dhe as indirekt nuk ndikon ky studim ne zone te mbrojtura si Monumente te Kultures.

### **Blegtoria**

Edhe kapacitetet prodhuese blektorale jane te kufizuara. Kukesi ze respektivisht vetem 4% dhe 5% te prodhimit kombetar te qumeshtit dhe mishit. Detyrat e prodhimit blegtoral gjithnje e me shume jane duke u trajtuar te lidhura me rritjen e numrit te fermave blegtorale te orientuara nga tregu.

### **Aksesi ne Infrastruktura dhe Sherbime**

Aksesi i rajonit ne infrastrukturen rrugore dhe lidhja me pjesen tjeter te vendit sidomos kryeqytetin, aeroportin dhe portet eshte permiresuar se tepermi, sidomos pas investimit ne rrugen Durres-Kukes-Morine gjate 2007-2010 (koha e udhetimit eshte shkurtuar me 240 minuta). Lidhja me Tiranen behet nepermjet rruges nacionale Kukës – Tirane, me gjatesi 144 km dhe pershkohet per 120 minuta. Me aeroportin e Rinasit rajoni lidhet me rrugen nacionale Kukës – Vore – Rinas, me gjatesi 124 km, e cila pershkohet per 90 minuta. Distancat e rajonit nga portet kryesore te vendit, Durres dhe Vlore jane perkatesisht 160 km (135 min) dhe 291 km (300 min).

Qarku ka akses ne dy pika doganore; ate te Morines nepermjet rruges nacionale Kukës – Morine, me gjatesi 20.5 km dhe distance kohore 20 minuta; dhe doganen Qafe Prush – rruga nacionale Kukës – Krume – Qafe Prush, me gjatesi 55 km, e cila pershkohet per 90 minuta. Rajoni eshte 99 minuta larg Pukes (qarku Shkoder), 50 minuta nga Rresheni (Qarku Lezhe) dhe 150 minuta nga Peshkopia (Qarku Diber).

Rajoni, fale autostrades qe e lidh me pikat kyce te vendit eshte tashme me i hapur per perspektiva te reja zhvillimi biznesi apo investime te ndryshme. Aksesit me i lehte dhe infrastruktura e permiresuar ka influencuar dhe rritur perdorimin vetjak/personal te makinave, duke e rritur ate me 37 % qe nga 2006.

### **Industria**

Rajoni i Kukesit konsiderohet i pasur me minerale, ne vecanti krom, mermer, gips, çimento. Uji dhe burimet termale jane nje tjetër aset i rendesishem per rajonin.

Perpara viteve '90 prodhimi i kromit ishte ne nivele shume te larta, gje qe e rendiste Shqiperine ne vend te trete ne rang boteror. Nje pjese e konsiderueshme e banoreve te qytetit dhe te fshatrave punonin ne zonen nxjerrse dhe perpunuese te kromit ne Kalimash, ne minieren e nxjerrjes se bakrit ne Gjegjan, etj. Gjithashtu ne kete periudhe Kukesi kishte nje industri te nxjerrjes dhe shkrirjes se bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimit te mineralit te kromit, nxjerrjes se mineralit te kuarcit, prodhimit te materialeve te ndertimit (materiale inerte, parafabrikate etj), perpunimit te lendes drusore dhe prodhimit te mobilieve, prodhimit te qilimave dhe sixhadeve, prodhimeve ushqimore, mbledhjes dhe perpunimit te bimeve mjekesore, prodhime te industrise mekanike.

Pas viteve 90 pati nje renie drastike te prodhimit te kromit dhe ne vitin 2003 nxirrej rreth 110 mije ton. Kjo situatë pati ndikim ne rritjen e papunesise.

Gjithsesi kromi mbetet aseti me i madh i rajonit si burim te ardhurash nga eksportet, dhe fale zhvillimeve te fundit ne infrastrukture, ka marre nje shtytje te re zhvillimi.

### **Bujqesia**

Sipas te dhenave, rajoni i Kukesit ka nje siperfaqe prej 2,373 km<sup>2</sup>, ku karakterizohet nga pjese shume te uleta te tokes bujqesore (11 %), pjese te larta te pyjeve dhe kullotave (64%) pjese te vogla te tokes tjetër (25%). Siperfaqet me pjese me te madhe te tokes bujqesore (me shume se 20% e struktures se pergjithshme se tokes) vihen re ne; Komunat Fajza (27%), Shishtavec (27%), Llugaj (26%), Kalise (24%), Ujmisht (23%) Bushtrice (20%), Topojan (20%). Qarku i Kukesit eshte shume i pasur me pyje dhe kullota, ku 70% e njesive te qeverisjes vendore te qarkut kane me shume se 50% pyje dhe kullota ne strukturen e tyre tokesore. Nivelet e uleta te tokes bujqesore dhe struktura e fragmentuar e tokes jane per shkak te ndryshimit te larte te terrenit. Perdorimi i tokes bujqesore ne qark eshte 0.22 ha per fryme ndersa toka are e punuar per fryme eshte 0.11 hektare (49% e tokes bujqesore).

Ndaj rajoni ka kapacitete shume te vogla prodhuese bujqesore dhe blegtorale. Ky prodhim sherben kryesisht vetem per te kenaqur nevojat e brendshme te rajonit, madje edhe keto te fundit jo gjithmone ne masen e duhur.

### ***Vleresimi i Ndikimeve***

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme, qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky projekt ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te impianteve.

### **Ndryshimet ne popullsi**

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te impiantit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit. Nga ky investim kemi nje punesim te rreth 12 vetave, banore te kesaj zone.

### **Ndikime te dukshme ne zonat rrethuese dhe peisazh**

Gjate ndertimit e shfrytezimit eshte marre ne konsiderate sistemimi gradual i terrenit, duke e pershtatur me ate te zones, si dhe nderkohe te mos kete demtim te siperfaqeve te gjelberuara perreth tij. Aktiviteti shoqerohet me ndryshimet te pjesshme ne peisazh, por pa ndikime potenciale ne vlerat natyrore, qe lidhen me ekosistemet. Zbatimi i masave rehabilituese do te reflektoje ne zbutjen e ndikimit, duke permirsuar situaten mjedisore.

### **Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga aktiviteti zhvillues.**

Prodhimi i inerteve dhe ai i betonit jane procese, te cilat emetojne zhurma te matshme, dhe brenda normave te lejuara, duke perfshire zhurmat gjate thyerjes dhe mjetet, te cilat transportojne lenden e pare. Mjetet e transportit jane te kolauduara periodikisht, ndersa per makinerite dhe paisjet niveli i zhurmave eshte brenda normativave te lejuara. Ndikimi i tyre ne zonen perreth eshte i paperfillshem, sepse kantieri eshte rreth 1.5 – 2 km larg zonave te banuara (ku qyteti i Kukesit eshte rreth 2 km larg), krahas faktit se eshte parashikuar te punohet vetem me nje turn (ora 07:30 deri 16:30).

### **Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga aktiviteti gjate fazes normale te operimit.**

Projekti parashikon masa sigurie ne menyre rigoroze gjate zbatimit, duke ndjekur punimet nga persona te specializuar, si dhe duke monitoruar sipas nje programi korrekt shkarkimet ne ajer, uje, toke ne perputhje me kerkesat ligjore. Gjate punimeve per mirembajtje duhet te mbahen parasysh masat per sistemimim e materialeve, evitimin e derdhjeve dhe perhapjeve kaotike si çimento, etj, si edhe te evitohet masa e pluhurit, duke perdor doemos sperktatjen me uje rast pas rasti.

Subjekti ka parashikuar nje grope dekantimi per te evituar shperndarjen e llumrave, nepermjet dekantimit paraprak, grope e cila sherben edhe per dekantimin e ujerave siperfaqesore te reshjeve, qe krijohen ne sheshin e punes se objektit.

Kujdes duhet te tregohet per te evituar derdhjet aksidentale te vajrave apo naftes gjate nderrimit te filtrave, gomave nga automjetet, si dhe rrjedhjet e mundshme nga makineri-paisjet. Ne rast te derdhjeve aksidentale, kjo mbetje do pastrohesh permes tallashit ose reres dhe do te depozitohet ne fuci te mbyllura hermetikisht. Gjithashtu, per largimin e saj nga subjekti, do lidhen kontrata me subjekte te licensuara per trajtimin dhe transferimin e kesaj mbetje.

### **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin.**

Subjekti ka krijuar rruge hyrese dhe rruge dalese nga superstrada per ne kantier, te cilat i miremban ne vazhdimesi. Veprimtaria e punes gjate shfrytezimit te impianteve behet jashte kesaj rruge, duke mos patur ndikim ne demtime te rruges, pengesa te trafikut etj. Gjate zbatimit te aktivitetit nuk do kete ndryshime te rjetit te rrugeve lokale dhe transportit. Per rrjedhoje aktiviteti nuk do ndikojte absolutisht ne rruget lokale dhe transport, perkundrazi subjekti eshte angazhuar te mirembaje rruget lokale te transportit me qellim te mbarevajtjes se mire te aktivitetit te tij.

### **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike**

Aktivitetet, qe ushtron firma "KUKES INERTE" Sh.p.k, zbatohen ne nje zone, ne siperfaqen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon, qe zona eshte zone e lire jo vetem, per te realizuar prodhimin e inerteve, por njekohesisht nje zone ne te cilen aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotese per mjedisin.

### **Ndikimet ne floren dhe faunen**

Zona, ne siperfaqen e se ciles ndertohet impianti i fraksionimit te inerteve dhe i prodhimit te betonit, eshte nje zone ku nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Si rrjedhoje e llojit te veprimtarise, faktit qe sheshi qe do perdoret nuk shoqerohet me demtim te ndonje bimesie, por edhe shkarkimeve qe ka gjate punes nga kjo veprimtari, nuk kemi ndikim ne floren perreth.

### **Ndikimet ne toke**

Si gjate veprimtarise, ashtu edhe pas perfundimit te shfrytezimit te objektit nuk do te kete ndryshime topografike lokale.

Mbetjet me fraksion mbi 20 mm e linjes se fraksionimit do te perdoren per mbushje dhe rilevime te territorit, si dhe ne linjen e bluarjes.

Ne projekt jane parashikuar disa masa suplementare te mbushjes, sistemimit e trajtimit te zones rreth objektit, si dhe mbjelljes se fidaneve, ne menyre qe te reflektoje ne zbutjen e ndikimit, duke permirsuar situaten mjedisore.

Gjithashtu, vendi ku depozitohet lenda e pare eshte i shtruar me beton dhe qe ne fazen e ndertimit eshte e veshur me nje shtrese gjeotekstile e cila nuk lejon depertimet ne toke.

Kujdes do te tregohet edhe ne rehabilitimin e mjedisit ne rast largimi te linjes, duke e kthyer tere siperfaqen ne kushte optimale.

### **Ndikimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit ne atmosfere kemi shkarkime si grimca te ngurta dhe gaze (SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, CO<sub>x</sub>), shkaktuar respektivisht nga pluhuri gjate procesit te punes dhe levizjes se mjeteve te transportit ne kantier. Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se bluar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Ne raste te tilla subjekti perdor sperkatjen me uje here pas here, ndersa makinat transportuese jane te mbuluara. Gazrat prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra, brenda normavete lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth.

### **Ndikimet ne ujera**

Kompania ka marre masa qe ujerat industrial, qe perdoren ne linjen e fraksionimit, ujerat e shesheve te punes dhe te reshjeve, te orientohen ne grope dekantuese, per te evituar derdhjet e llumrave dhe mbetjeve te ngurta. Sasia e ujerave industriale te linjes se bashku me ujerat siperfaqesore te krijuara nga reshjet etj., duhet te plotesojne perpara shkarkimit ne mjedisin ujqor prites, parametrat brenda normave ligjore, duke iu nenshtruar monitorimit periodik sipas ligjit. Gjithashtu, vendi ku depozitohet lenda e pare eshte i shtruar me beton dhe qe ne fazen e ndertimit eshte e veshur me nje shtrese gjeotekstile e cila nuk lejon depertimet ne toke dhe ne ujerat nentokesore.

### **Ndikimet ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore**

Siperfaqja e vene ne dipozicion per kete objekt eshte toke inproduktive, pasi eshte zallishte e cila deri tani nuk ka paraqitur ndonje interes te vecante praktik per veprimtari te tjera. Kjo siperfaqe prej 8738 m<sup>2</sup>, nuk eshte toke bujqesore, nuk ka konflikt pronesie si dhe nuk ndikon ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore ne zonen Kukesit.

### **Ndikimet ne perdorim te burimeve**

Objekti nuk ka ndikime ne burime te tjera te zones si uje, energji etj. Sasia e mases inerte qe do te perpunohet eshte mesatarisht rreth 60 000 m<sup>3</sup>/vit.

Sasia e ujit, qe mund te perdoret ne linjen e larjes e sperkatjet e shesheve te punes etj, nuk ka ndikim ne ujrata siperfaqesore apo nentokesore.

## **2. Masat parandaluese per te zbutur ndikimet ne mjedis.**

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise jane marr keto masa konkrete:

#### **▪ *Territorri perreth impiantit***

I gjithë territori i kantierit dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Perzgjedhja e teknologjise eshte bere me cikel te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore, ku instalimi i makinerive eshte bere korrekt, sipas skemes teknologjike te permiresuar.

Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth duke bere te mundur mbjelljen me peme. Gjithashtu nga stafi tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe sperkatjen e tij here pas here me uje.

#### ▪ ***Emetimet ne ajer***

Referuar natyres se procesit ne atmosfere kemi shkarkime te grimcave te ngurta dhe gaze (SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, CO<sub>x</sub>) te shkaktuara respektivisht nga pluhuri gjate procesit te punes dhe gjate levizjes se mjeteve per ne kantier. Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se bluar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre, qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Ne raste te tilla subjekti perdor sperkatjen me uje here pas here.

Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurter, brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth.

Transporti i materialit inert behet i ngadalte, me mjete te pastra sidomos nga balta, ku gjithashtu gjate transportit mjetet jane te mbuluara ne menyre, qe te parandalojne rrjedhjet e materialit ne rruge dhe krijimin e pluhurave.

#### ▪ ***Mbetjet e ngurta***

Mbetje teknologjike fraksion i imet nga linja e inerteve ( mase e imet tip argjilore ) qe varion 1- 5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar, mase e cila kalon me ujerat. Kjo mase pas dekantimit sistemohet dhe riperdoret nga zona.

Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linjes se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rievime, si dhe rifutet ne proces ne linjen e bluarjes. Kjo sasi mbetje eshte 5-10 % te sasise se lendes se parete perdorur. Sterilet apo mbetje te tjera perdoren per nevoja teknologjike ose vendosen per rehabilitimin e zones se shfrytezimit.

#### ▪ ***Shkarkimet e ujerave***

Kompania ka marre masa qe ujerat industrial, qe perdoren ne linjen e fraksionimit, ujerat e shesheve te punes dhe te reshjeve, te orientohen ne grope dekantuese, per te evituar derdhjet e llumrave dhe mbetjeve te ngurta. Sasia e ujerave industriale te linjes se bashku me ujerat siperfaqesore te krijuara nga reshjet etj., duhet te plotesojne perpara shkarkimit ne mjedisin ujqor prites, parametrat brenda normave ligjore, duke iu nenshtruar monitorimit periodik sipas ligjit.

#### ▪ ***Zhurmat***

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim-shkarkimit, sitat vibruese, mulliri, dhe perzieresit. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore, megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Njekohesisht per te minimizuar zhurmat ne anen lindore eshte ndertuar nje zone me mur te larte, qe ndikon si ekranizues dhe zbut sadopak efektin e tyre ne shtepite e aferta. Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne turnin e pare. Ndaj ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth.

#### ▪ ***Rastet aksidentale***

Jane masat per parandalimin e tyre, mjetet ne impiante kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrikante apo karburant.

Shoqeria siguron se do kete te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.



▪ ***Kushtet e punes***

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata jane te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria i ka pajisur me uniforma dhe mjete mbrojtese.

▪ ***Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese***

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes ne shoqerine "KUKES INERTE" Sh.p.k do te cojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerzve dhe mjedisin perreth.

Nga zbatimi korrekt i ketyre masave do te arrihet:

- Krijim te nje zone pune optimale per veprimtari te kesaj natyre.
- Evitim te ndotjeve ne uje, ajer dhe toke.
- Evitim i erozionit dhe permbytjeve ne zone e objektit dhe afersi te tij.
- Ambiente optimale higjeno-sanitare
- Permiresim i siperfaqes se gjelbert ne objektet rreth tij.
- Vendosje e tabelave sinjalizuese afer objektit, ne pershtatje me kerkesat ligjore te trafikut rrugor, ndricim sipas nje projekti tip per objekte te kesaj natyre.

▪ ***Programi i monitorimit***

Nga shoqeria monitorohen elementet me ndikim ne mjedis. Te dhenat cilesore, hidhen ne nje regjister, qe administrohet nga vet kompania dhe relatohet ne Agjensine Kombetare te Mjedisit, sipas kushteve te percaktuara ne lejen mjedisore.

Shoqeria kujdeset per administrimin e cdo informacioni, qe lidhet me ushtimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem, per menyren e operimit te Shoqerise dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e cdo mase te parashikuar, per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi e monitorimit mjedisor te veprimtarise.

